

VENDIM
Nr.3, datë 23.1.2006

PËR MIRATIMIN E AKSIONARËVE ME PJESËMARRJE INFLUENCUESE NË
SHOQËRINË E SIGURIMIT “DUKAGJINI AL” SHA

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 57 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe shkronjës “f” të nenit 6 dhe të shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 20.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen influencuese të aksionarëve të shoqërisë së sigurimit “Dukagjini AL” sh.a. si më poshtë:

- a) Kadri Morinaj aksionar me pjesëmarrje prej 75% të aksioneve;
- b) Faik Bruci aksionar me pjesëmarrje prej 12% të aksioneve.

2. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve rezervon të drejtën e revokimit të miratimit të pikës 1 të këtij vendimi në rast se më vonë do të rezultojë:

- a) është dhënë mbi bazën e informacionit të pasaktë ose të rremë;
- b) rrezikon veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit sipas parashikimeve të kreut 6 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

Ky vendim hyn në fuqi më 23.1.2006.

KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera